



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 936/1 prot.

Tiranë, më 15. 07. 2021

V E N D I M

Nr. 132, datë 15. 07. 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 07, datë 03.02.2021, të Dh. B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*” dhe “*gjendjes arsimore*”, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Klos, I. H.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, shtetasi Dh. B. në ankesën e sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) pretendon se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit të tij, Bashkia Klos, duke e larguar nga puna. Mbështetur në aktet e vëna në dispozicion bashkëngjitur ankesës, Dh. B. pretendon se ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Klos në vitin 2008, fillimisht duke ushtruar detyrën e Agjentit Tatimor për Taksën e Tokës dhe të Ndërtesave. Më pas me Vendimin Nr. 3, datë 29.02.2008, është emëruar në pozicionin e Përgjegjës të Policisë Bashkiake Klos. Më datë 16.09.2011, ankuesi është transferuar në pozicionin e Inspektorit të Ndërtimit, të cilin e ka mbajtur deri më datë 18.04.2014, kur është emëruar Inspektor i Çështjeve Sociale.

Sipas ankuesit, sapo I. H. është emëruar në pozicionin e Kryetarit të Bashkisë Klos, ai është paraqitur në zyrën e tij për ta informuar rreth detyrës që ai ushtron dhe detyrat që ka mbajtur gjatë 12 viteve punë në Bashkinë e Klosit. Gjithashtu, ankuesi ka vënë në dijeni punëdhënësin e tij se për arsye ekonomike ishte i punësuar edhe në një subjekt privat, pas orarit zyrtar të punës në Bashkinë Klos. Ankuesi pretendon se nga ana e punëdhënësit i është thënë se nëse nuk cënon punën në Bashkinë Klos, ai mund të vijojë të ushtrojë punën në subjektin privat. Më pas në muajin Tetor 2019, pretendon se është thirrur nga I. H., ku i është thënë se nuk mund të vijojë

dypunësimin e tij. Në këto kushte, ankuesi është detyruar të lërë punën në subjektin privat dhe ka vijuar ushtrimin e detyrës së Inspektorit të Çështjeve Sociale.

Në fund të muajit Tetor 2019, ndaj ankuesit kanë nisur procedurat për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për shkak të shkurtimeve të pozicionit të punës dhe mospërmbushjes së kriterit arsimor. Në këto kushte, ai është paraqitur në zyrën e punëdhënësit të tij, duke i kërkuar arsyet që çuan në marrjen e vendimit për largimin nga puna. Sipas ankuesit, nga ana e punëdhënësit i është sqaruar se është bërë një gabim në marrjen e këtij vendimi dhe në Janar 2020, me miratimin e strukturës së re organizative ai do të rikthehej në detyrë. Në vijim ankuesi ka vijuar të shkojë punë deri më datë 31.12.2019 dhe nga ana e punëdhënësit i është thënë që gjatë muajit Janar 2020 të shfrytëzojë lejen vjetore dhe në muajin Shkurt do të rikthehej në punë. Pas kësaj periudhe ankuesi sqaron se mbeti pa punë dhe pa asistencë sociale për shkak të tejkalimit të afateve.

Pas largimit nga puna, ai ka aplikuar për punësim pranë Policisë Bashkiake dhe strukturës së Zjarrëfikseve të Bashkisë Klos, por nuk është marrë në punë duke refuzuar aplikimin e tij për shkak të moshës, pavarësisht se ankuesi kishte ushtruar për 3 vite detyrën e Përgjegjës të Policisë Bashkiake.

Ankuesi sqaron se në zgjedhjet lokale të vitit 2019, në krye të Bashkisë Klos është zgjedhur I. H., propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Sapo ai ka marrë detyrën, ka nisur të largojë nga puna një numër të madh punonjësish të cilët kishin bindje politike të kundërta me të. Në këtë kuadër, sipas Dh. B. edhe largimi i tij nga puna është bërë menjëherë pas emërimit të I. H. në detyrën e Kryetarit të Bashkisë Klos, për shkak të bindjeve të tij politike, pasi ai mban pozicionin e kryetarit të Seksionit të Partisë Demokratike Klos Katund.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Bashkisë Klos, për shkaqet sipërcituara, si dhe marrjen e masave për rregullimin e situatës duke e rithyer në gjendjen e mëparshme.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 07, datë 03.02.2021 të Dh. B. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 236/1 prot., datë 16.02.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Klos, për ankesën e bërë nga Dh. B.

Me shkresën¹ nr. 440/1 prot., datë 10.03.2021, Bashkia Klos, në mes të tjerash informoi se: “Dh. B. me Vendimin nr. 4/1, datë 11.03.2013 “Për lëvizje paralele të punonjësve” është liruar nga detyra Inspektor Ndërtimi dhe është emëruar në pozicionin Inspektor i Çështjeve Sociale, duke e

¹ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 236/2 prot., datë 19.02.2021

pranuar këtë pozicion pune dhe duke vijuar më tej me ushtrimin e detyrës në këtë pozicion deri me datë 01.11.2019, datë në të cilën, është marrë Vendimi nr. 88, datë 01.11.2019 “Për largim nga detyra”, ku Dh. B. është larguar nga detyra Specialist i Çështjeve Sociale në Sektorin e Mirëqenies, Kujdesit Social dhe Barazisë Gjinore pranë Bashkisë Klos, sipas procedurave përkatëse ligjore, për arsye të shkurtimit të pozicionit të punës, si pasojë e ristrukturimit të institucionit dhe mospërmbushjes së kriterit arsimor.

Sqarojmë se, pozicioni Specialist i Çështjeve Sociale në Sektorin e Mirëqenies, Kujdesit Social dhe Barazisë Gjinore pranë Bashkisë Klos, është pozicion i shërbimit civil dhe, si i tillë, plotësimi i tij duhet të bëhet vetëm nëpërmjet një procedure të hapur konkurimi. Në rastin konkret, nuk ka ndodhur kështu, por përkundrazi, Dh. B. është emëruar në këtë pozicion përmes një vendimi të dalë nga titullari, çka nuk e përlligj emërimin e tij në këtë pozicion pune. Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil nga verifikimet e herë pas herëshme të kryera në institucionin tonë, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune, që janë pjesë e shërbimit civil, gjë e cila vërtetohet me vendimin e tij të fundit nr. 150, datë 03.12.2019, bashkangjitur kësaj shkrese.

Vendimi i Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, si organi më i lartë i mbikqyrjes së zbatueshmërisë së legjislacionit të shërbimit civil nga institucionet publike, është një fakt dhe argument i rëndësishëm që Bashkia Klos ka zbatuar ligjin dhe pretendimet e Dh. B. nuk qëndrojnë dhe nuk janë ligjore. Në kuadër të ristrukturimit të institucionit, në strukturën e re organizative të Bashkisë Klos, të miratuar me datë 15.10.2019 dhe, që ishte në fuqi në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës së Dh. B., kemi shkurtim të njërit prej pozicioneve të punës Specialist i Çështjeve Sociale në Sektorin e Mirëqenies, Kujdesit Social dhe Barazisë Gjinore pranë Bashkisë Klos, pasi në strukturën paraardhëse kishim dy pozicione të tilla. Kjo vërtetohet edhe nga strukturat përkatëse organizative të Bashkisë Klos, përkatësisht ajo e datës 01.02.2019 dhe 15.10.2019, bashkangjitur kësaj shkrese.

Si pasojë, Dh. B., duke qënë edhe në kushtet e emërimit të paligjshëm dhe po ashtu edhe të mospërmbushjes së kriterit arsimor për pozicionin që mbante, është larguar nga puna, duke ndjekur të gjithë hapat ligjore nga ana jonë dhe nuk është aspak e vërtetë që Dh. B. është larguar për shkak të bindjeve politike, siç pretendon ai vetë. Ne nuk kemi dijeni për sa i përket mbajtjes së pozicioneve nga ana e tij në sferën politike, siç citohet në shkresën tuaj.

Për më tepër, Dh. B., është sqaruar imtësisht edhe nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, sa herë ka qënë e nevojshme dhe për çdo paqartësi që ka patur, si para, edhe pas largimit nga detyra...”

Sa i përket emërimeve në Sektorin e Policisë Bashkiake dhe në Sektorin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (në vijim MNZH), të Bashkisë Klos, u sqarua ndër të tjera se: “...emërimet janë bërë konform legjislacionit përkatës në fuqi, ku kandidatët i janë nënshtruar një procesi të hapur konkurimi. Pjesë e këtij procesi ka qënë edhe Dh. B., i cili nuk është renditur në listën e

kandidatëve fitues, duke qënë se nuk përmbushte kriteret e përcatuara, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Në Sektorin e MZSH-së, pas miratimit të strukturës organizative të vitit 2020, me krijimin e tre pozicioneve të lira pune, janë bërë tre emëtime të reja, sipas listës me kandidatët fitues, përkatësisht të moshës 22, 25 dhe 32 vjeç, me arsim të mesëm, në pozicionin e punës Zjarrëfikës në Sektorin e MZSH-së.

Në Sektorin e Policisë Bashkiake, pas miratimit të strukturës organizative të vitit 2020, me krijimin e tre pozicioneve të lira pune, janë bërë tre emëtime të reja, sipas listës me kandidatët fitues, përkatësisht të moshës 26, 26 dhe 32 vjeç, me arsim të mesëm”.

Ndërsa, lidhur me arsimin e punonjësve të çështjeve sociale, u theksua se: “...para ndryshimeve të strukturës organizative kishim dy pozicione pune Specialist të Çështjeve Sociale dhe dy punonjës të emëruar në këto pozicione pune, konkretisht, Dh. B., me arsim të mesëm dhe Znj. V. M., me arsim të lartë. Pas ristrukturimit të institucionit kemi një pozicion pune Specialist i Çështjeve Sociale dhe një nëpunës të emëruar në këtë pozicion pune, përmes një procedure të hapur konkurimi, Znj. V. M., me arsim të lartë.

Përmes Vendimit nr. 85, datë 25.09.2019 “Për ndryshim të numrit të përgjithshëm të punonjësve për vitin 2019”, të Këshillit të Bashkisë Klos, numri i përgjithshëm i punonjësve reduktohet në 220 (dyqind e njëzet) punonjës nga 245 (dyqind e dyzet e pesë) punonjës, që ishte miratuar përmes vendimeve të mëparshme. Në të tilla kushte, lind nevoja e ristrukturimit të institucionit, i cili është kompetencë e titullarit të institucionit dhe për realizimin e tij është ngritur Urdhëri nr. 153, datë 23.09.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin/përditësimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë Klos” dhe më pas në kuadër të këtij procesi, ka operuar edhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit.

Pas ndryshimeve të pësuar në strukturën organizative, janë emëruar 8 (tetë) punonjës, sipas akteve të emërimit bashkëngjitur kësaj shkrese dhe janë larguar 19 (nëntëmbëdhjetë) punonjës, sipas akteve të largimit bashkëngjitur kësaj shkrese.

Me arsim të mesëm, pas ndryshimeve të strukturës organizative të institucionit, janë emëruar 3 (tre) punonjës në pozicionin e punës “Specialist të mesëm në Sektorin e Shërbimit Pyjor” dhe janë larguar 11 (njëmbëdhjetë) punonjës, ndërsa para ndryshimeve të strukturës organizative është larguar 1 (një) punonjës me arsim të mesëm dhe nuk është emëruar asnjë punonjës me arsim të mesëm. Bashkëngjitur një kopje e akteve të emërimit/largimit të këtyre punonjësve...”

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar Bashkia Klos, vuri në dispozicion të KMD-së, informacionin e kërkuar, si më poshtë vijon:

- Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me ndryshimet e pozicionit dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin;

- Kopje të strukturës organizative të Bashkisë Klos, përpara dhe pas ndryshimeve të pësuara;
- Kopje të dosjes personale të Dh. B.;
- Kopje të dokumentacionit (akti i largimit) për punonjësit e tjerë të Bashkisë Klos, me të cilët janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, si rezultat i ndryshimeve të pësuara në strukturën organizative;
- Kopje të dokumentacionit (akti emërimit) për punonjësit e emëruar pranë Bashkisë Klos, pas ndryshimeve të pësuara në strukturën organizative.

2. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, në datën 29.04.2021, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore publike. Seanca u zhvillua me pjesëmarrjen e ankuesit dhe përfaqësuesve të Bashkisë Klos.

Në vijim të seancës Dh. B. parashtroi edhe një herë shkurtimisht situatën diskriminuese të pretenduar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit.

Nga përfaqësuesit e Bashkisë Klos, u parashtuan edhe një herë argumentat e dhënë më parë sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues. Gjithashtu, u theksua fakti se ankuesi dhe një grup punonjësish në të njëjtat kushte me të, të cilët ishin emëruar në pozicionet përkatëse të punës në shkelje të procedurave të shërbimit civil, janë marrë masat për largimin e tyre, duke qënë se ishte lënë rekomandim edhe nga Komisioneri i Mbikqyrjes së Shërbimit Civil.

Më pas, ankuesi sqaroi faktin se pas largimit nga pozicioni i Specialistit të Çështjeve Sociale, ka aplikuar për punonjës të Policisë Bashkiake dhe të MZSH të Bashkisë Klos, por nuk është përzgjedhur.

Sa i përket këtij pretendimi, nga ana e Bashkisë Klos, u sqarua se nga informacioni dhe dokumentacioni i depozituar nga Dh. B. në protokollin e Bashkisë, nuk rezulton që prej tij të jetë paraqitur asnjë aplikim për punonjës të Policisë Bashkiake, por vetëm për punonjës të MZSH. Në vijim, u theksua se në fazën e parë të konkurimit, Komisioni i Vlerësimit, nuk e ka kualifikuar ankuesin si kandidat për fazat e tjera të konkurimit.

Në këtë kuptim nga përfaqësuesit e Komisionerit, iu kërkua Dh. B. nëse disponon ndonjë dokument apo provë sa i përket aplikimit për punonjës të Policisë Bashkiake, por nga ana e tij u theksua se nuk e administron një të tillë.

² Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

Në përfundim të seancës dëgjimore nga ana e Komisionerit, iu kërkua që Bashkia Klos të vinte në dispozicion të shqyrtimit të ankesës, kopje të procedurës së ndjekur për konkurimin e kandidatëve për punonjës të MZSH, moshën e secilit kandidat dhe kopje të ndryshimeve të strukturave.

3. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri iu drejtua Bashkisë Klos, Nëpërmjet e-mailit datë 15.06.2021, duke i kërkuar:
 - Argumentimin, lidhur me arsyen e skualifikimit të subjektit ankues nga konkurimi për punonjës të MZSH-së.
 - Kopje të ndryshimeve të pësuara në strukturën organike të Bashkisë Klos gjatë periudhës 2019-2021.
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit me anë të të cilit të evidentohet mosha e secilit kandidat të skualifikuar në fazën e parë të konkurimit.

Në përgjigje përsa më lart, Bashkia Klos me anë të e-maileve³ datë 15.06.2021 dhe 17.06.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Pas verifikimeve të kryera, lidhur me depozitimin e kërkesave të kandidatëve për punësim në Sektorin e Policisë Bashkiake, rezulton se Dh. B., nuk ka depozituar një kërkesë të tillë në protokoll, edhe pse njoftimi për shpalljen e vendeve të lira në Sektorin e Policisë Bashkiake, ka qenë i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Klos... Bazuar në procesverbalin e datës 03.03.2020, komisioni përkatës i ngritur sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 18, datë 07.02.2020 “Për ngritje komisioni mbi rekrutimin e punonjësve të MZSH-së”, bazuar në ligjin Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri”, mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin përkatës të kandidatëve për punësim në këtë sektor dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga kandidatët aplikues, skualifikon kandidatët që nuk përmbushin kriteret ligjore dhe kualifikon kandidatët që përmbushin kërkesat sipas legjislacionit në fuqi, gjë për cilën Dh. B. është informuar në email.*

Shpallja e pozicioneve të lira të punës në këtë sektor është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Klos në linkun përkatës: [https://www.bashkiaklos.gov.al/notices/per-pranimin-ne-sherbimin-e-mzsh-se-sektori-per-sherbimin-e-mbrojtjes-nga-zjarri-dhe-shpetimi/...](https://www.bashkiaklos.gov.al/notices/per-pranimin-ne-sherbimin-e-mzsh-se-sektori-per-sherbimin-e-mbrojtjes-nga-zjarri-dhe-shpetimi/)”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

³ Të administruara në cilësinë e provës në dosjen e subjektit ankues.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankuesit për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur për largimin e tij nga puna, për shkak të bindjes politike dhe gjendjes arsimore.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimet e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar⁴ dhe Kodi i Punës, i ndryshuar⁵, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Bazuar në pretendimet e ngritura nga ana e Dh. B., Komisioneri u ndal në 3 momente për analizimin e tyre.

⁴ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*

⁵ Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

a) Ndërprerja e marrëdhënieve të punës në pozicionin Specialist i Çështjeve Sociale.

Mbështetur në informacionin e administruar nga palët në proces, Dh. B. ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Klos dhe është emëruar për herë të parë pranë këtij subjekti përmes kontratës individuale të punës nr. 01 prot., datë 01.01.2008, në pozicionin e punës Agjent Tatimor i grumbullimit të takses së zënies së hapësirës publike, me kohëzgjatje deri më 29.02.2008. Me Vendimin nr. 03, datë 29.02.2008 *“Për emërim punonjësi në punë”* është emëruar në pozicionin Përgjegjës i Policisë Bashkiake, detyrë të cilën e ka ushtruar deri më datë 16.09.2011, ku me Vendimin nr. 19, datë 16.09.2011 *“Për lëvizje paralele”* është liruar nga detyra Përgjegjës i Policisë Bashkiake dhe është emëruar në pozicionin e punës Inspektor Ndërtimi.

Me Vendimin nr. 4/1, datë 11.03.2013 *“Për lëvizje paralele të punonjësve”* është liruar nga detyra Inspektor Ndërtimi dhe është emëruar në pozicionin Inspektor i Çështjeve Sociale, duke vijuar më tej me ushtrimin e detyrës në këtë pozicion deri më datë 01.11.2019, datë në të cilën është marrë Vendimi nr. 88, date 01.11.2019 *“Për largim nga detyra”*. Referuar këtij vendimi, Dh. B. është larguar nga detyra Specialist i Çështjeve Sociale në Sektorin e Mirëqenies, Kujdesit Social dhe Barazisë Gjinore pranë Bashkisë Klos, për arsye të shkurtimit të pozicionit të punës, si pasojë e ristrukturimit të institucionit dhe mospërbushjes së kriterit arsimor.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Klos u zgjodh I. H., mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Pak kohë pas emërimit të I. H. në krye të Bashkisë Klos, mbështetur në nenit 64/j të Ligjit nr. 139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”* i ndryshuar, ku parashikohet një ndër kompetencat e kryetarit të bashkisë është: *“miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi”*, me Urdhërin nr. 160, datë 15.10.2019, u miratua Struktura dhe Organika e re e Bashkisë Klos. Me miratimin e saj, disa nga pozicionet e punës u shkurtuan duke reduktuar numrin e punonjësve në 220, nga 245 që ishin më parë⁶. Ndryshimet e pësuara në strukturë prekën edhe pozicionet e punës së Sektorit të Mirëqenies, Kujdesit Social, Barazisë Gjinore dhe IT, ku pjesë e së cilës ishte dhe Dh. B.. Numri i punonjëse të Sektorit të Mirëqenies, Kujdesit Social, Barazisë Gjinore dhe IT nga 6 u reduktua në 3 dhe nga 2 pozicione Specialist të Çështjeve Sociale që ishin më parë, u reduktua në 1 pozicion

Më poshtë pasqyrohet si ka ndryshuar Sektori i Mirëqenies, Kujdesit Social, Barazisë Gjinore dhe IT:

⁶ Referuar Vendimit Nr. 122, datë 20.12.2018 të Këshillit Bashkiak Klos

Sektori i Mirëqënies, Kujdesit Social, Barazisë Gjinore dhe IT (6 pozicione pune)	Sektori i Mirëqënies dhe Kujdesit Social (3 pozicione pune)
Specialist i Çështjeve Sociale – 2 pozicione (shërbimi civil)	Përgjegjës Sektori - 1 pozicion (shërbimi civil)
Specialist i Barazisë Gjinore – 1 pozicion (shërbimi civil)	Specialist i Barazisë Gjinore dhe i Mbrojtjes së Gruas – 1 pozicion (shërbimi civil)
Specialist IT – 2 pozicione (shërbimi civil)	Specialist i Çështjeve Sociale - 1 pozicion (shërbimi social)
Punonjës i Zyrës me një ndalesë – 1 pozicion (me kod pune)	

Nga informacioni i administruar, evidentohet se rregullimi i marrëdhënieve të punës për pozicionet e Specialistëve të Çështjeve Sociale, të Barazisë Gjinore dhe Specialist IT, bëhej mbështetur në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Ndërsa pozicioni i Punonjësit të Zyrës me Një Ndalesë rregullohej me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07. 1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Gjithashtu, nga ndryshimet e strukturës u reduktuan edhe pozicionet e Specialistëve IT dhe pozicioni i Punonjësit të Zyrës me Një Ndalesë.

Përsa më sipër, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Klos, u nis procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për të gjithë punonjësit që prekeshin nga ndryshimi i Strukturës. Në këtë kuptim, gjatë muajit Nëntor 2019, u larguan edhe punonjësit që bënë pjesë në Sektorin e Mirëqënies, Kujdesit Social, Barazisë Gjinore dhe IT, si më poshtë vijon:

- Me vendimin nr. 88, datë 01.11.2019, u njoftua Dh. B., i cili mbante pozicionin *Specialist i Çështjeve Sociale*, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, për arsye të shkurtimit të pozicionit të punës, si pasojë e ristrukturimit të institucionit të Bashkisë Klos dhe mospërbushjes së kriterit arsimor.
- Me vendimin nr. 94, datë 01.11.2019, u njoftua shtetasi E. K., i cili mbante pozicionin *Specialist IT-së*, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, si pasojë e ristrukturimit të institucionit të Bashkisë Klos.

Gjithashtu, rezulton se në zbatim të urdhërit nr. 65 datë 12.09.2019, Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil ka kryer verifikimin në lidhje me evidentimin e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Klos. Më datë 06.12.2019, Bashkia Klos është vënë në dijeni të shkresës nr. 1625/2 prot., datë 03.11.2019, të Komisionerit

për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, me lëndë: “Dërgohet vendimi paralajmërues nr. 150, datë 03.11.2019, i Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil”, ku ndër të tjera citohet: “...kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Klos, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshme, 32 rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil dhe të rregullojë pasojat për punonjësit...”.

Referuar vendimit të sipërcituar të Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil (në vijim KMSHC), evidentohet se ndër 32 personat e emëruar në shkelje të legjislacionit “Për nëpunësin civil”, është edhe Dh. B. dhe Specialisti i IT-së. Nga përmbajtja e vendimit të KMSHC-së, konstatohet fakti se Bashkisë Klos i është lënë detyrimi të shpallë pozicionet e shërbimit civil vakante dhe të vijojë realizimin e procedurave të konkurimit sipas strukturës aktuale dhe nevojave që do të ketë institucioni në momentin e ekzekutimit të vendimit. Në vijim, referuar Vendimit Nr.75, datë 21.07.2020, të KMSHC-së “Për përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 150, datë 03.12.2019, në institucionin Bashkia Klos”, evidentohet se Bashkia Klos, në mbështetje të detyrimeve të lëna, ka zbatuar vendimin e KMSHC-së, duke ndërprerë marrëdhënien e punësimit me të gjithë punonjësit (32) të emëruar në kundërshtim me ligjin.

Në analizë të Strukturës Organizative të Bashkisë Klos, miratuar me Urdhërin nr. 14, datë 01.02.2019, nga Kryetari i mëparshëm i Bashkisë Klos, rezulton që pozicioni i Specialistit të Çështjeve Sociale, ku ishte emëruar Dh. B., ishte pozicion në të cilin marrëdhëniet e punës lidheshin mbështetur në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Përpara ndryshimit të Strukturës Organizative të Bashkisë Klos (të miratuar me Urdhërin nr. 14, datë 01.02.2019), ekzistonin 2 pozicione pune Specialist të Çështjeve Sociale, ku ishin të emëruar Dh. B. dhe shtetësja V. M.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga palët, rezulton se Dh. B. ishte emëruar në këtë pozicion me vendimin nr. 4/1, datë 11.03.2013, referuar ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ndërsa shtetësja V. M. ishte konfirmuar nëpunëse civile me aktin e konfirmimit nr. 2576 prot., datë 05.10.2018, referuar procedurave të parashikuara në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Pas ndryshimeve të pësuara në Strukturën Organizative të Bashkisë Klos, me emërimin e I. H. në krye të Bashkisë Klos, pozicionet Specialist të Çështjeve Sociale nga 2 u reduktuan në 1 të vetëm. Në këto kushte, Komisioni i Ristrukturimit të Bashkisë Klos, ngritur me Urdhërin nr. 164, datë 23.10.2019, pas verifikimit të pozicioneve të punës ka vlerësuar që shtetasja V. M., e konfirmuar më parë si nëpunëse civile, të vijojë marrëdhëniet e punësimit me Bashkinë Klos në

pozicionin Specialiste e Çështjeve Sociale, ndërsa Dh. B., për shkak se nuk plotëson kriterin arsimor (duke qënë se është me arsim të mesëm), t'i ndërpriten marrëdhëniet e punës.

Komisioneri vlerëson se, pas ndryshimit që pësoi Sektori i Çështjeve Sociale, Mirëqënies, Kujdesit Social dhe Barazisë Gjinore, pas datës 15.10.2019, ankuesi, bazuar në arsimin e tij, nuk mund të emërohej në pozicionet e reja si specialist në këtë sektor, pasi ato kishin si kriter arsimin e lartë. Gjithashtu, ankuesi ishte vlerësuar edhe nga ana e KMSHC-së, si punonjës i emëruar në shkelje të legjislacionit sa i përket nëpunësit civil.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Klos, sa i përket largimit nga pozicioni i punës Specialist i Çështjeve Sociale, apo emërimi në pozicionet e reja të Sektorit të Mirëqënies dhe Kujdesit Social. Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Klos, për shkaqet e pretenduara nga subjekti ankues, sa i përket largimit nga pozicioni Specialist i Çështjeve Sociale.

Gjithashtu, mbështetur në kërkesë padinë datë 28.04.2020, të paraqitur nga palët, me objekt procedurat e ndjekura sa i përket zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, është një proces që do të trajtohet nga organet gjyqësore dhe jo nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

b) Moskualifikimi i ankuesit në pozicionin e Punonjësit të Policisë Bashkiake Klos

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, i cili në nenin 64, parashikon: “...Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra: g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësisve në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;...j) miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësisve e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;”, Kryetari i Bashkisë Klos me Urdhërin nr. 14, datë 04.02.2020 “Për ngritje komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të Punonjësve të Policisë Bashkiake Klos”, në muajin Shkurt 2020, ka nisur procedurën për dhe ngritur komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve të Policisë Bashkiake Klos. Më pas, në faqen zyrtare të Web-it të Bashkisë Klos, më datë 10.02.2020, është publikuar⁷ njoftimi për vende të lira pune për punonjës të Policisë Bashkiake Klos.

Mbështetur në njoftimin e publikuar janë përcaktuar edhe kriteret e konkurimit për pozicionet e lira të punës së Policisë Bashkiake.

⁷ <https://www.bashkiaklos.gov.al/notices/per-pranim-ne-policine-bashkiake-prane-bashkise-klos/>

Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga palët në proces, referuar në njoftimin e sipërcituar, ankuesi nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë provë apo fakt nëse ka paraqitur aplikimin e tij, për punonjës të Policisë Bashkiake. Gjithashtu, nga ana e Bashkisë Klos, u theksua fakti që ankuesi nuk kishte depozituar pranë protokollit aplikimin e tij për konkurimin në pozicionet e lira të punës si punonjës i Policisë Bashkiake.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Klos, sa i përket konkurimit për pozicionin e lirë të punës si punonjës i Policisë Bashkiake. Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Klos, për shkaqet e pretenduara nga subjekti ankues, sa i përket mos emërimit në pozicionin punonjës i Policisë Bashkiake.

c) Moskualifikimi i ankuesit në pozicionin e Punonjësit të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH)

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, i cili në nenin 64, parashikon: “...Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra: g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësisive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;...j) miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësisive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;”, Kryetari i Bashkisë Klos me Urdhërin nr. 18, datë 07.02.2020 “Për ngritje komisioni mbi rekrutimet e punonjësve të MZSH-së Klos”, në muajin Shkurt 2020, ka nisur procedurën për dhe ngritur komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve të MZSH-së Klos.

Më pas, në faqen zyrtare të Web-it të Bashkisë Klos, më datë 10.02.2020, është publikuar⁸ njoftimi për vende të lira pune për punonjës të MZSH-së Klos. Referuar kritereve për pranimin në strukturat e MZSH-së, rezulton që kandidati duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;

⁸ <https://www.bashkiaklos.gov.al/notices/per-pranimin-ne-sherbimin-e-mzsh-se-sektori-per-sherbimin-e-mbrojtjes-nga-zjarri-dhe-shpetimi/>

- Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.
- Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.
- Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";
- Kandidati për personelin drejtues automjetesh zjarrfikëse dhe shpëtimi në shërbimin e MZSH-së duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi automjeti, grupi "D", si dhe me leje drejtimi të veçantë shërbimi, konform kërkesave të Kodit Rrugor. Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesione si mekanik, shofer, hidraulik, marangoz, infermier, elektrikist etj.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 520, datë 25.07.2019 *“Për miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*, në nenin 42/1 përcakton se: *“1. Struktura vendore e MZSH-së dhe njësia e burimeve njerëzore në bashki shqyrton formularin e aplikimit, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga aplikanti, për të verifikuar nëse ai plotëson kriteret e përgjithshme të përcaktuara në ligj dhe në rregullore.”*

Mbështetur në njoftimin e sipërcituar dhe Procesverbalin Nr. 853, datë 24.03.2020 *“Për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve të MZSH-së, të Bashkisë Klos”*, rezulton që kanë depozituar aplikimin e tyre 36 (tridhjetë e gjashtë) kandidatë, nga të cilët janë kualifikuar për në fazën e dytë, atë të testimit me shkrim, 8 (tetë) prej tyre. Ndërkaq, ankuesi dhe 25 (njëzet e pesë) kandidat të tjerë janë skualifikuar nga konkurimi për shkak mungesës së dokumentacionit dhe mospërmbushjes së kriterëve ligjore për pranimin në MZSH.

Në përfundim të procedurës së konkurimit për punonjës të MZSH-së, janë shpallur fitues kandidatët:

- E. M., i moshës 22 vjeç, me arsim të mesëm;
- E. H., i moshës 25 vjeç, me arsim të mesëm;
- E. C., i moshës 32 vjeç, me arsim të mesëm.

Neni 14, pika 1 e Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, përcakton kriteret e pranimit për nivelin bazë të këtij shërbimi, të cilat janë:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;

ç) të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;

d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm;

dh) të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje;

e) të jetë i/e moshës nën 30 vjeç;

ë) të ketë përfunduar testimin fizikoprofesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës.”

Ndërkaq, në zbatim të ligjit të sipërcituar, VKM-ja Nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, në Nenin 39, pika 1/ë, përcakton kriteret për pranimin e kandidatëve të MZSH-së, si më poshtë:

“1. Kandidati për pranimin në nivelin bazë të shërbimit vendor të MZSH-së duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

a) Të jetë shtetas shqiptar;

b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;

ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;

d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;

dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).

ë) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;

f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;

g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;

gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.

h) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.

- i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.
- j) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";
- k) Kandidati për personelin drejtues automjetesh zjarrfikëse dhe shpëtimi në shërbimin e MZSH-së duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi automjeti, grupi "D", si dhe me leje drejtimi të veçantë shërbimi, konform kërkesave të Kodit Rrugor. Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesione si mekanik, shofer, hidraulik, marangoz, infermier, elektrikist etj."

Referuar dokumentacionit dhe provave të administruara, rezultojnë që kandidatët E. M. dhe E. H., i plotësonin kriteret për pranimin në strukturat e MZSH-së, ndërsa kandidati E. C., nuk plotëson kriterin moshë, pasi kishte 2 (dy) vite diferencë me kriterin e parashikuar në nenin 14, pika 1/e e Ligjit Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe nenin 39, pika 1/ë të VKM-së së sipërcituar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga ana e Bashkisë Klos, informacion lidhur me arsyen e skualifikimit nga konkurimi të ankuesit dhe 25 (njëzet e pesë) kandidatëve të tjerë, por një informacion i tillë nuk është vënë në dispozicion të shqyrtimit të çështjes. Pavarësisht kësaj, Komisioneri evidenton se ankuesi, siç është pretenduar edhe prej tij, nuk plotëson kriterin moshë të parashikuar në nenin 14, pika 1/e të Ligjit Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe nenin 39, pika 1/ë të VKM-së Nr. 520, datë 25.07.2019 "Për miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin". Nga dokumentacioni i administruar, ankuesi rezultojnë të ishte 43 vjeç, në momentin që ka aplikuar për pozicionin e punës në MZSH. Pra, në këtë kuptim ai nuk mund të bëhej pjesë e strukturave të MZSH-së.

Nga verifikimi i kandidatëve fitues, rezultoi që 1 (një) prej tyre ishte emëruar në shkelje të kriterit moshë të parashikuar në nenin 14, pika 1/e e Ligjit Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe nenin 39, pika 1/ë të VKM-së Nr. 520, datë 25.07.2019 "Për miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin". Sipas kriterit të parashikuar, mosha e kandidatëve të MZSH-së duhet të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç. Pra, njëri prej kandidatëve të kualifikuar, ishte i moshës 32 (tridhjetë e dy) vjeç në momentin e konkurimit.

Në analizë të informacionit të analizuar më sipër, Komisioneri vëren se shihet një trajtim i pabarabartë ndërmjet ankuesit dhe kandidatit të E. C. Pavarësisht faktit që emërimi i kandidatit E. C., është bërë në shkelje të legjislacionit, nuk vërehet një trajtim i padrejtë i tij, pasi përmbushja e kriterëve ligjorë për emërimin në strukturat e MZSH-së është një detyrim i parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në këtë kuptim, pretendimi i ankuesit për tu emëruar në strukturat e MZSH-së, vjen në shkelje të akteve ligjore të sipërcituara dhe si i tillë nuk mund të legjitimohet nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjithashtu, në Nenin 19 të ligjit nr. Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe në Nenin 78 të VKM-së Nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, parashikohen kufizimet e të drejtave politike dhe të drejtës së grevës, ku theksohet se:

Punonjësi me grada i shërbimit të MZSH-së:

a) nuk ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo të shprehë publikisht bindjet dhe preferencat e tij politike;

b) nuk mund të jetë anëtar i një partie apo organizate politike dhe me veprimtarinë e tij nuk duhet të cenojë natyrën e depolitizuar të institucionit;

c) nuk ka të drejtën e grevës.

Në analizë për sa më sipër, duke qënë se ankuesi ka pretenduar pranë Komisionerit faktin që është anëtar i subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë dhe bindjet politike të tij i ka ekspozuar në aktivitete të ndryshme të zhvilluara nga ky subjekt politik, në çdo rast nuk mund të bëhej pjesë e strukturave të MZSH-së, duke qënë se punonjësi me grada nuk mund të marrë pjesë në veprimtari politike apo të shprehë publikisht bindjet dhe preferencat e tij politike, si dhe nuk mund të jetë anëtar i një partie apo organizate politike.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se nuk kemi të bëjmë me një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues nga ana e Bashkisë Klos.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë apo të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Klos, dhe në mungesë të një trajtimi të tillë, nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese kundrejt ankuesit, për shkaqet e pretenduara prej tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit Dh. B. nga ana e Bashkisë Klos për shkaqet e pretenduara prej tij.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore dhe bindjet politike)
(Fusha: Punësim)